



Pas barazimit të arritur në kryeqytet nga skuadra e Partizanit ndaj ekipit të Flamurtarit, trajneri Hasan Lika u shpreh i kenaqur nga loja që ekipi i tij zhvilloi, por perseri theksoi se gabimi i bere tek gjuajtja e penalltise duhej të evitohet.

"Gabuam në fund të ndeshjes dhe më vjen shumë keq. Penalltia e humbur na hoqi një fitore por janë gjera që ndodhin. Sot lujatëm më mirë se ndeshjet e tjera. Është e evidente që kemi probleme me sulmin sepse krijuam shumë raste dhe nuk i shfrytëzojmë. Krasniqi është gjuajtësi i penalltive dhe ka shënuar shumë të tilla. Por dua të them që ndeshjet as fitohen as humben nga një individ i vetëm por nga i gjithë ekipi. Mendoj se ishte edhe aftësi e Moçkës për të shënuar penalltise. Në çdo ndeshje lojtarët bëjnë të pamundurën për të arritur tek goli por kemi vështirësi në qendër të sulmit që të themë mbrojtjet kundërshtarë. Në po punojmë që të përmirësojmë të gjitha aspektet. Mendoj se penalltia ishte e drejtë sepse lojtari kundërshtar preku topin me dorë. Për momentin nuk po mendojmë për Tiranën por vetëm për Kukësin që është ndeshja e radhës. Partizani sipas të tjerëve ka 2 detyra, fitimin e kampionatit dhe të mundi Tiranën. Por këto janë problemet e medias dhe të tifozave. Si ekip ne duhet të punojmë dhe mendojmë vetëm për ndeshjen e radhës, Kukësin", theksoi Lika në prononcimin e tij për mediat pas përfundimit të takimit me Flamurtarin.